

AKTI I THEMELIMIT
TË
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"KOMPLEKSI DRILONI I-J" SH.P.K.

Bazuar në ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare (i ndryshuar)" dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve QKB (i ndryshuar)", sot më datën 19 TETOR 2022 unë ortaku:

Jetmir Hydri Muçllari me Shtetësi Shqiptare i identifikuar me "Leternjoftim/card Shqiptare "Nr 036980934 dhe IDI-n H30503109D, me datëlindje 03 Maj 1973, Lindur në në Buçimas të Pogradecit, Shqipëri dhe banues në adresën Ndërtesë private, Fshati Buçimas 7304, Njësia administrative Buçimas" Pogradec vendosa të krijoj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K. me adresë kryesore "Ndërtesë private në Drilon, Tushemisht, Nr i pasurisë 2/40, ZK 3664". Pogradec. Për këtë qëllim hartoj këtë "Akt Themelimi" me këto kushte

Neni 1

Në kuptimin e këtij Akti Themelimi, ortaku Jetmir Hydri Muçllari është themelues i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K, e cila ka selinë në adresën: "Ndërtesë private në Drilon, Tushemisht, Nr i pasurisë 2/40, ZK 3664". Pogradec

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar emërtohet me emrin "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**"SH.P.K. Me këtë Akt Themelimi, bazuar në Legjislacionin Shqiptar në fuqi, rregullon pozitën juridike të ortakëve dhe pozitën juridike e statusin e Administratorit të shoqërisë.

Bazuar në këtë Akt Themelimi dhe në Statutin e hartuar për Shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K, rregullohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të shoqërisë, të dhenat me rëndësi për pozitën dhe qëllimin juridik të saj, organizimi, aktiviteti financiar, objekti i veprimtarisë së shoqërisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e saj.

Neni 2

Veprimtaria e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K, marrëdhëniet e saj me persona të tretë private e shtetërore, rregullohen në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare (i ndryshuar)", të ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve QKB (i ndryshuar)", me akte të tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme e të ligjeve të tjera, si dhe në bazë të Statutit e të këtij Akti Themelimi të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K.

Neni 3

Për Detyrimet e Veta, shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K, përgjigjet me pasuritë e saj.

Neni 4



Akti i Themelimit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "KOMPLEKSI DRILONI I-J" SH.P.K

Objekti i veprimtarisë, emërtimi, selia e shoqërisë, shtimi i ortakëve dhe ato çka janë përcaktuar në këtë "Akt themelimi" dhe më pas në Statutin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K, mund të ndryshojnë me vendimin e "Asamblesë së ortakëve" dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë tregtare të Shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K do të jetë:

-Ngritja dhe shfrytëzimi bareve, restoranteve dhe hotele: - Ngritja dhe përdorimi agjensive turistike, exchangeve dhe I agjensive publicitare: -Ndërtimi i objekteve të shërbimit dhe të banimit, i objekteve industriale, i objekteve bujqësore dhe veprave të artit me karakter bujqësor, i rrugëve, kanalizimeve, ujesjellsave dhe shkarkueseve: -Prodhim dhe tregëtim me shumicë e pakicë i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit: -Projektme në fushën e ndërtimeve për të gjitha llojet e tyre dhe për të gjitha kategoritë e punimeve brënda vendit: -Investime dhe sipërmarrje për instalimin e sistemeve të ngrohjes dhe të freskimit të objekteve gjatë procesit të ndërtimit ose në procesin e rikonstruksionit të tyre:-Grumbullimi, prodhimi dhe perpunimi i artikujve bujqësore, ushqimore, i nënprodukteve të gatëshme e gjysëm të gatëshme: - Ngritja dhe shfrytëzimi i linjave të industrisë ushqimore për përpunimin e frutave, të perimeve, të peshkut dhe të mishit: -Prodhimi dhe dhe tregëtimi me shumicë e pakicë i të gjitha llojeve të pijeve alkolike dhe jo alkolike: -Import-eksporti i lëndëve të para, i mallrave industrial, ushqimore, dhe i mallrave të natyrave të tjera, i makinerive dhe i materialeve e paisjeve ndihmese për montimin dhe mirembajtjen e tyre: -Aktivitetet në zbulimin e burimeve minerare dhe në shfrytëzimin e tyre për të gjitha kategoritë e mineraleve: -Veprimtari në fushën imobilare si shitje, blerje dhe dhënie me qera të pronave dhe pasurive të paluajtshme; -Aktivitetet prodhimi, shërbimi dhe përpunimi në dru, mobileri, në metal, plastikë, në xhama, në qeramikë, në gur, në çimento, në kulturat bujqësore, në kultivimin e luleve natyrale, në pyje dhe në akuakulturë: -Shërbime të ndryshme ndaj publikut me rrobaqepsi, parukeri, transport brënda e jashtë vendit: -Tregti me shumicë e me pakicë i karburanteve të llojeve të ndryshme, i vajrave lubrifikantë dhe i nën produkteve të tjera të naftës. Të gjitha veprimtaritë e mësipërme do të realizohen në të drejtën e importit dhe eksportit komform kërkesave specifike të legjislacionit Shqiptar për sejcilën veprimtari.

Neni 6

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe e ka selinë kryesore të saj në adresën: "**Ndërtesë private në Drilon, Tushemisht, Nr i pasurisë 2/40, ZK 3664**". **Pogradec** Ajo mund të krijojë filiale, degë e përfaqësi brenda e jashtë vendit në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe të vendeve të tjera ku mund të vendosë filiale në të cilat do të ushtrojë aktivitetin.

Neni 7

Akti i Themelimit do të jetë efektiv nga dita e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K në Regjistrin Tregtar pranë "Qendrës Kombëtare të regjistrimit të Bizneseve QKB". Nga kjo ditë shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K, fiton statusin e Personit Juridik të pavarur, por aktivitetin e saj mund ta ushtrojë pasi të jetë regjistruar në "Drejtorinë Rajonale të Tatimeve", në "Sistemin Doganor" dhe në "Zyrat e Taksave të Qeverisjes Vendore" ku ushtron aktivitetet. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**KOMPLEKSI DRILONI I-J**" SH.P.K duhet të jetë e licencuar nga organet kompetente për ushtrimin e veprimtarive ku licencimi i aktivitetit është kërkesë detyruese nga ligjet specifike që rregullojnë aktivitetet tregtare.

Neni 8

Kohëzgjatja e aktivitetit të veprimtarisë së shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “KOMPLEKSI DRILONI I-J” SH.P.K do të jetë e pakufizuar.

Neni 9

Kapitali Themeltar i shoqërisë tregtare “KOMPLEKSI DRILONI I-J” SH.P.K është 100,000.00 (njëqindmijë) lekë. Sipas ligjit, Kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100.00 lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në Kapitalin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “KOMPLEKSI DRILONI I-J” SH.P.K është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:

Zoti Jetmir Hydri Muçllari është Ortak i vetëm, zotëruesi i një kuote me vlerë të përgjithshme në masën 100,000.00 (njëqindmijë) lekë, e cila përbën 100%. (njëqind përqind) të Kapitalit Themeltar të shoqërisë.

Ky Kapital në masën 100%, në vlerën 100.000.00 (njëqindmijë) lekë do të jetë i derdhur tërësisht në Bankë brenda 30 ditëve pas firmosjes së Statutit të Shoqërisë Tregtare “KOMPLEKSI DRILONI I-J” SH.P.K.

Kuotat e pjesëmarrjes në Kapital janë të ndashme në rast suksedimi për shkak vdekjeje ose tjetërsimi. Në rast bashkëpronësie të një pjesëmarrjeje, të drejtat e bashkëpronarëve duhet të ushtrohen nga një përfaqësues, i mandatuar, nga të gjithë të përfaqësuarit.

Neni 10

Administratori i Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar “KOMPLEKSI DRILONI I-J” SH.P.K do të jetë zoti Indrit Jetmir Muçllari me Shtetësi Shqiptare i identifikuar me “Ietnjoftim-card Shqiptare ”Nr 036976743 dhe IDI-n me Nr J41216024J, me datëlindje 16.12.1994, Lindur në qytetin Pogradec dhe banues në në adresën: Ndërtesë private, Fshati Buçimas 7304, Njësia administrative Buçimas Pogradec, për një periudhë deri në 5 vjet me të drëjtë riemërimi ose rizgjedhjeje nga “Asambleja e ortakëve” i cili nuk ndalohet nga ligji, nuk ka konflikte interesi dhe nuk është i lidhur në marrdhënje te tjera në konceptin e personave të lidhur të cilat mund të prekin figurën e tij nga kërkesat e nenit 13 të ligjit “Për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar).

Detyrat konkrete që mund të kryhen prej Administratorit, të cilat janë të autorizuar nga Asambleja e Ortakëve, konkretisht janë të përcaktuara në Statutin e kësaj shoqërie tregtare.

Neni 11

Aktet dhe çdo dokument i shoqërisë “KOMPLEKSI DRILONI I-J” SH.P.K hartohen nga Ortakët, nga “Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë”, nga Administratori apo nga organet zbatuese të saj, firmosen prej “Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë” ose vetëm nga Administratori i shoqërisë sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin shqiptar.

Emërtimi i shoqërisë do të shënohet në të gjitha dokumentet duke u ndjekur menjëherë nga inicialet “SH.P.K”. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “KOMPLEKSI DRILONI I-J” SH.P.K do të ketë vulën me logo të veçantë dhe me specimente të veçanta, e cila do të përdoret në të gjitha dokumentet e hartuara gjatë gjithë veprimtarisë së saj.

Neni 12



Akti i Themelimit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “KOMPLEKSI DRILONI I-J” SH.P.K

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**KOMPLEKSI DRILONI I-J**” SH.P.K gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka te drejtë t’i përdorë ato në përputhje me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së saj dhe legjislacionin në fuqi.

Pas miratimit të Bilancit vjetor dhe të Raportit Financiar vjetor nga Asambleja e Ortakëve, Fitimi Neto u përket Ortakëve në masën e kontributit të tyre në Kapitalin Themeltar dhe mund të përdoret lirisht prej tyre brenda e jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 13

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**KOMPLEKSI DRILONI I-J**” SH.P.K mund të krijojë disa фонде. Ajo mund të krijojë: Fondin Themeltar, Fondin Rezervë e Fondin e Shpërblimit. Për zhvillimin e veprimtarisë së vet shoqëria mund të përcaktojë dhe të krijojë edhe фонде të tjera.

Neni 14

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “KOMPLEKSI DRILONI I-J”SH.P.K do të çelë llogari në Banka të ndryshme. Ajo do ta mbajë llogarinë dhe do ta deklarojë në Lekun Shqiptar por mund të mbajë llogaritë edhe në EURO, USD e në monedha të tjera të huaja.

Në bankat shoqëria mund të hapë llogari dhe të veprojë njëkohsisht me Lekun Shqiptar dhe me të gjitha monedhat e huaja në qarkullim.

Veprimet bankare do të kryhen nga Administratori, zoti Indrit Jetmir Muçllari me Shtetësi Shqiptare i identifikuar me “letrnjoftim-card Shqiptare ”Nr 036976743 dhe IDI-n me Nr J412160243, me datëlindje 16.12.1994, Lindur në qytetin Pogradec dhe banues në në adresën: Ndërtesë private, Fshati Buçimas 7304, Njësia administrative Buçimas Pogradec, për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë rëmërimi ose rizgjedhjeje nga “Asambleja e ortakëve”

Ai mund të veprojë me llogaritë bankare të shoqërisë personalisht ose edhe mund të autorizojë një person të tretë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 15

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**KOMPLEKSI DRILONI I-J**” SH.P.K mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti. Bilanci vjetor i shoqërisë tregtare “**KOMPLEKSI DRILONI I-J**” SH.P.K duhet të miratohet nga “Asambleja e Ortakëve” brenda muajit Mars të vitit pasardhës, kurse vendimi për destinacionet e përdorimit të Fitimit Neto duhet të merret gjithashtu nga “Asambleja e Ortakëve” brenda datës 30 Qershor të vitit pasardhës.

Neni 16

Për nevoja të veprimtarisë së saj shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**KOMPLEKSI DRILONI I-J**” SH.P.K mund të bëjë punësime të punonjësve duke lidhur kontrata sipas legjislacionit në fuqi duke respektuar veçanërisht detyrimet që përcakton Kodi i punës për krijimin e kushteve të punës nga Pundhënësi në secilin vend ku ushtron veprimtarinë e saj shoqëria bazuar në rregullat konkrete të vendosura në Statut.

Neni 17

Ortakët dhe personat që do të punësohen në shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**KOMPLEKSI DRILONI I-J**”SH.P.K janë të detyruar të ruajnë karakterin e fshehtë të dokumentacionit, të informacionit e të burimit të tij, njohuritë e përvojën e fituar apo shkëmbyer në kuadrin e veprimtarisë së shoqërisë, si dhe fshehtësinë e gjendjes financiare të saj. Ata janë të detyruar të ruajnë të fshehtë identitetin e shumave të depozituara, identitetin e burimeve të



Akti i Themelimit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "KOMPLEKSI DRILONI I-J" SH.P.K

investimeve, destinacionet e të ardhurave të shoqërisë, e të depozitave të saj si dhe veprimtarinë e shoqërisë nga goditjet direkte dhe indirekte të konkurrencës. Ndaj atyre që shkelin këto rregulla, Asambleja e Ortakëve dhe Administratori kanë të drejtë të marrin masa ndëshkuese.

Neni 18

Kjo shoqëri tregtare merr cilësinë si "Person Juridik" me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë QKB-së. Ky Akt Themelimi i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "KOMPLEKSI DRILONI I-J" SH.P.K nënkupton se kjo shoqëri tregtare është deklaruar e krijuar me regjistrimin e saj në "Regjistrin Tregtar" dhe më pas të dhënat e saj janë të transferuara dhe të deklaruar në "Qendrën Kombëtare të Biznesit QKB". Përfundimisht ajo konsiderohet e krijuar nga dita kur ka fituar statusin e Personit Juridik.

Neni 19

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Ortakëve, si dhe ndërmjet Ortakëve dhe shoqërisë "KOMPLEKSI DRILONI I-J" SH.P.K në lidhje me raportet shoqërore ose për interpretimin dhe për zbatimin e këtij "Akti Themelimi" dhe të vendimeve ligjërish të nxjerra nga "organet e shoqërisë", nga ato të emëruara prej "Asamblesë së Ortakëve" dhe nga Administratorët, nga likuidatorët dhe nga titullarët ose në raportet me ta, për sa janë shtruar për kompromis, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe kur ato nuk gjejnë zgjidhjen e pranuar, secila palë mund t'i drejtohet Gjykatës në rrethin në të cilin shoqëria ka Selinë.

Kur mirëkuptimi me kompromise nuk arrihet pavarësisht nga negociatat e realizuara midis palëve, atëherë të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis "shoqërisë tregtare" dhe palëve të tjera do të zgjidhen nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "KOMPLEKSI DRILONI I-J" SH.P.K ka selinë saj ose në Gjykatën territoriale ku ka ndodhur ngjarja.

Neni 20

Përsa nuk është shprehimisht e përcaktuar në këtë Akt Themelimi dhe në Statutin shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "KOMPLEKSI DRILONI I-J" SH.P.K, vlejnë dispozitat e ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare (i ndryshuar)" dhe të ligjeve të posaçme të fushës së aktivitetit tregtar.

ORTAKU THEMELUES

Jetmir Hydri Muçllari

Jetmir Muçllari

Indrit Muçllari

Indrit Muçllari